



**Organization for Security and Co-operation in Europe
Presence in Albania**

9 korrik 2010

**FJALA E AMBASADORIT ROBERT BOSCH NË FORUMIN
“EVROPA – NDËRMJET MEJE DHE TEJE”, NË VLORË**

Hyrje

I dashur z. Velaj, miq të nderuar, zonja dhe zotërinj, ju faleminderit shumë dhe më vjen shumë mirë që jam me ju këtu sot.

Si ambasador i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, jam personi i katërt ndërkombëtar që flas në lidhje me BE-në. Kjo mund të duket pak e çuditshme pasi unë as nuk e përfaqësoj BE-në dhe as nuk punoj për të drejtpërdrejt. Ndaj, ajo që dua të bëj është t’ju paraqes një tablo të shkurtër të historisë së organizatës sime; strukturën e saj dhe atë që ajo përfaqëson, sidomos në lidhje me aspiratat e vazhdueshme të Shqipërisë për integrim, pasi siç do ta shihni, ka disa lidhje midis aktiviteteve tona dhe atyre që e afrojnë vendin tuaj dhe që kanë afruar edhe vendet para jush me strukturat e BE-së.

Sigurisht, do të sigurohem që të le kohë të mjaftueshme në fund për pyetje.

Hulumtimi im i parë mbi historinë e OSBE-së do të prekë rritjen e OSBE-së që nga fillimet e saj në Helsinki derisa ajo u kthye në një organizatë me një shtrirje vërtet globale, e cila është e angazhuar në mënyrë aktive në parandalim e zgjidhje konfliktesh, si dhe në procesin e rehabilitimit që pason konfliktet. OSBE-ja angazhohet edhe në aktivitete të tjera mbi sigurinë, të drejtat e njeriut e të tjera.

Historia

Nënshkrimi i Aktit Final të Helsinkit në datën 1 gusht 1975 ishte një moment historik.

35 krerë shtetesh zgjodhën të angazhoheshin në mënyrë të pakthyeshme për një dialog me përfitime reciproke në vend të shkatërrimit të sigurt për të gjithë.

Akti Final i Helsinkit ishte një marrëveshje bazë në shumë aspekte.

Një nga aspektet më kuptimplotë ishte që ai i bëri çështjet që lidheshin me të drejtat e njeriut një shqetësim legjitim për të gjithë. Deri atëherë ato përfaqësonin një temë të paprekshme në marrëdhëniet midis Lindjes dhe Perëndimit.

Me Aktin Final të Helsinkit, vendet nuk mund të përpiqeshin më që të mbulonin shkeljet e të drejtave të njeriut nga kontrolli ndërkombëtar, duke pretenduar se ato ishin çështje të tyre të brendshme. Këtu u hodhën themelet e para për përmirësimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në

gjithë zonën e asaj që atëherë ishte Komisioni për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (KSBE), përfshirë edhe ato vende që deri atëherë kishin qenë të mbyllura nën regjimin komunist.

Marrëveshja përmbante tre paketa kryesore parimesh, të njohura shpeshherë si tre 'shportat'.

Kishte çështje që lidheshin me aspektet politiko-ushtarake të sigurisë (shporta I), të cilat në atë kohë përbënin përparësinë kryesore; pastaj bashkëpunimi në ekonomi, shkencë, teknologji dhe mjedis (shporta II), kjo ishte me kërkesë të veçantë të atij që atëherë njihej si blloku lindor; dhe bashkëpunimi në fushën humanitare dhe në fusha të tjera (shporta III), që erdhi si rezultat i një kërkesë të veçantë të perëndimit.

Për një dekadë e gjysmë pas nënshkrimit të Aktit Final të Helsinkit, Konferenca për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (KSBE) shërbeu si një forum për dialog dhe si një katalizator për ndryshim; duke formuar një urë jetësore midis dy gjysmave të asaj që ishte ende një Evropë e ndarë ideologjikut, politikisht dhe ekonomikisht.

Sidoqoftë, asnjë prej 35 vendeve fillestare nënshkruese nuk mund ta kishte parashikuar shpejtësinë e habitshme me të cilën blloku komunist do të rrëzohej në fund të viteve 1980. Regjimet ranë njëri pas tjetrit, mes të tjerash si pasojë e lirisë për që po shfaqej ndaj ankesave absolute. Në atë kohë ishte e lehtë që të rrëmbeheshe nga ajo që ndihej si një atmosferë universale optimizmi.

Sidoqoftë, historia nuk pranoi të vdiste. Në Evropën Lindore dolën në sipërfaqe shumë tensione dhe rivalitete të vjetra etnike, politike dhe gjeografike.

Pavarësisht nga gjithë përpjekjet për t'i ndaluar, një sërë konfliktesh të përgjakshme do të shpërthenin në vitet e ardhshme.

Ishte e qartë se struktura e dhënë nga Helsinki për bashkëpunim nuk ishte më e mjaftueshme.

Ndërsa Bashkimi Sovjetik përgatitej që të shpërbëhej, KSBE-ja ishte e zënë me rikrijimin e vetvetes për të përballur sfidat e sigurisë së Evropës së re.

Në nëntor 1990, Krerët e Vendeve apo Qeverive të KSBE-së u mbledhën në Paris për atë që ishte Samiti i tyre i dytë për të hedhur bazat paraprake për transformimin e KSBE-së nga një Konferencë diplomatike në një Organizatë dedikuar promovimit të sigurisë dhe bashkëpunimit në Evropë.

Për të adresuar sfidat e reja të krijuara nga situata tashmë shpërthyes në shumë rajone të Evropës Lindore dhe përtej saj, KSBE-ja krijoi operacione të shumta në terren dhe organe të tjera.

Ky proces u shënjua me ndryshimin e emrit nga KSBE në OSBE në Samitin e Katërt të Krerëve të Vendeve, mbajtur në Budapest në dhjetor 1994.

Në fund të viteve '90, OSBE-ja kishte ngritur një numër të konsiderueshëm institucionesh dhe operacionesh në terren, numri i personave të të cilave varionte nga disa vetë në shumë më shumë se 1,000 në rastin e Kosovës.

Me metodat e tyre elastike dhe praktike të punës, këto operacione në terren kontribuuan gjerësisht në rritjen e sigurisë dhe stabilitetit në shumë vende të Evropës.

Por mbërritja e mijëvjeçarit të ri – larg prej futjes në një epoke të re paqeje dhe sigurie – vërtetoi edhe njëherë shprehjen e vjetër se çmimi i lirisë është vigjilenca e përhershme.

Ngjarjet e tmerrshme të 11 shtatorit në Shtetet e Bashkuara, dhe sulmet terroriste të mëvonshme në disa shtete anëtare të OSBE-së, nxorën në pah nevojën për një qasje më gjithëpërfshirëse ndaj sigurisë globale.

Ndërkohë, po fillonin të dëgjoheshin zëra të tjerë që kërkonin reforma të mëtejshme të OSBE-së.

Por a ishte OSBE-ja, e cila kishte arritur kaq shumë gjatë viteve nëntëdhjetë, vërtet e gatshme për të përballuar sfidat e shekullit të 21-të?

Kjo është një çështje që do të vazhdojë të diskutohet gjerë e gjatë ndërsa 56 shtetet pjesëmarrëse mendojnë për të ardhmen e saj.

Struktura

OSBE-ja, e përbërë nga 56 shtete anëtare nga Evropa, Azia Qendrore dhe Amerika Veriore, është organizata më e madhe rajonale për sigurinë në botë.

Si për çdo vendim brenda organizatës, edhe vendimi se kush do ta kryesojë organizatën për një vit merret me konsensus nga të gjithë 56 shtetet anëtare.

Imagjinoni të drejtoni një organizatë apo kompani me një bord prej 56 anëtarësh ku secili ka të drejtën e vetos.

Misioni i OSBE-së do të mund të ndalohej në çdo moment nga cilido anëtar mes të 56-ëve, e megjithatë kjo nuk ndodh; sepse të gjithë janë të interesuar për ta ruajtur këtë inerci, për të përmbushin angazhimet për të cilat kanë rënë dakord dhe për ta pasur këtë lloj presioni të përhershëm nga njëri-tjetri brenda organizatës.

Çdo të enjte në mëngjes bëhet mbledhja e Këshillit të Përhershëm, ku herë pas herë marrin pjesë të ftuar të veçantë, të cilët adresojnë çështje të caktuara – kryetarë misionesh në terren, kryetarë të institucioneve tona – dhe më pas çështje aktuale - që do të thotë çdo çështje e ngritur nga cilido anëtar në secilin prej tre dimensioneve.

Në këtë mënyrë trajtohen një sërë çështjesh të ndryshme dhe interesante.

Në 22 dhjetor 2009, Këshilli i Përhershëm i OSBE-së miratoi Buxhetin e Unifikuar të Organizatës për vitin 2010, një total prej mbi 150 milion euro.

OSBE-ja ka rreth 450 punonjës në institucionet e veta dhe rreth 3000 punonjës në operacionet e saj në terren.

Ka një sërë grupesh ekspertësh të ndryshëm që i përgjigjen thirrjes së vendeve mikpritëse për të ndihmuar në vendosjen e sigurisë dhe zbatimin e tre dimensioneve, standardeve dhe përkushtimeve të organizatës.

Ato janë produkt i një lloji 'tërheqjeje' midis vendit mikpritës dhe asaj çfarë 56 shtetet anëtare janë të gatshme të ofrojnë sa u përket burimeve.

Numri i punonjësve lokal është më i madh se numri i punonjësve ndërkombëtarë të dërguar nga shtetet përkatëse – një raport pothuajse pesë me një.

Punonjësit ndërkombëtarë financohen nga shtetet përkatëse.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri është një prej 19 operacioneve në terren. Ajo u vendos në Shqipëri në mars 1997 në përgjigje të mosfunksionimit të rendit dhe ligjit, me kërkesë të autoriteteve shqiptare dhe vendim të Këshillit të Përhershëm të OSBE-së.

Mandati i Prezencës u rishikua në dhjetor 2003 për të reflektuar progresin e përgjithshëm të arritur në Shqipëri në vitet e fundit dhe rolin pozitiv që ka luajtur vendi në zhvillimin dhe përmirësimin e marrëdhënieve në Evropën Jug-Lindore.

Prezenca punon në partneritet me Qeverinë dhe institucionet e tjera kombëtare për të përforcuar institucionet kryesore shtetërore, për të përforcuar sistemin demokratik të 'garancive dhe sigurive' dhe për të ushqyer dialogun midis palëve për të krijuar besim në këto institucione.

Në përmbushjen e qëllimit të saj të përgjithshëm, Prezenca fokusohet kryesisht në reformën legjislative dhe gjyqësore, reformën e pronës; reformën administrative rajonale; reformën zgjedhore; ngritjen e kapaciteteve parlamentare; anti-trafikimin dhe anti-korrupsionin; hartimin e ligjeve dhe rregulloreve efektive për një media të pavarur; promovimin e mirëqeverisjes dhe menaxhimit e projekteve të synuara për të forcuar shoqërinë civile; si dhe në ndihmën që i ofron policisë në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë. Fatkeqësisht, këto janë çështje që ende kërkojnë vëmendje, siç mund të lexojmë edhe në raportet e progresit të Komisionit Evropian.

Përveç selisë së saj në Tiranë, OSBE-ja mbështetet edhe nga katër zyrat e projekteve në Shkodër, Kukës, këtu në Vlorë dhe Gjirokastrë, të cilat ndihmojnë me koordinimin e projekteve të Prezencës jashtë Tiranës dhe në mbajtjen e kontakteve me aktorët kryesorë lokalë.

Përveç buxhetit kryesor prej rreth 3,3 milion Euro, Prezenca menaxhon edhe disa fonde të tjera jashtë buxhetit të siguruara nga shtetet anëtare të OSBE-së, që arrijnë një total prej mbi 2,2 milion Euro për vitin 2010.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka 108 punonjës –25 ndërkombëtarë, 17 ekspertë vendas dhe 62 staf mbështetës.

Më e rëndësishme për t'u theksuar është fakti që qëllimi i ndihmës së Prezencës ndaj Shqipërisë është të mbështesë procesin e vazhdueshëm të reformave drejt integritimit evropian. Ne ndihmojmë institucionet shqiptare të rrisin kapacitetet e tyre dhe të përgatisin ligjet e nevojshme

për këtë qëllim. Ne bashkëpunojmë ngushtë me Delegacionin e BE-së në Shqipëri, çfarë tregohet edhe nga fakti që Prezenca po zbaton një sërë projektesh të financuara nga BE-ja. Mund të përmend projektin për regjistrimin e pasurive të patundshme dhe adresave në zonat bregdetare me prioritet për Shqipërinë, si dhe projektin për asistencën teknike ndaj Qeverisë në lidhje me modernizimin e regjistrimit civil dhe sistemit të adresave. Së fundi, dhe më sfiduesja, është mbështetja për të zgjidhur problemet politike – dhe ata që lexojnë shtypin, e dinë se ndërhyrjet tona jo gjithmonë perceptohen si pozitive nga palët.

Konkluzione

Mesazhi kryesor i OSBE-së është ideja që siguria duhet të vijë në mënyrë ndër-dimensionale (i referohem tre shportave të sipërpërmendura që tani i quajmë dimensione) që të mund të krijojmë siguri të qëndrueshme në shtetet tona anëtare duke u bazuar në një sistem sigurie funksional, si në lidhje me çështjet politike edhe ato ushtarake, si dhe duke krijuar një bazë solide në fushën e ekonomisë dhe mjedisit.

Vula jonë unike është dimensionin njerëzor, fakti që nëse mungon respekti për të drejtat njerëzore, për dinjitetin e individit, si dhe rendi dhe perspektiva demokratike, asnjëherë nuk do të jemi në gjendje të krijojmë siguri të qëndrueshme. ‘Demokracia’ është fjala kyçe në këtë pjesë.

OSBE-ja përpiqet të ruajë paqen duke u përfshirë në ‘paralajmërimin’ dhe parandalimin e konfliktit në mënyrë që të mos krijohet një situatë ku konflikti ka ndodhur dhe duhet të përballemi me menaxhimin e krizës dhe rehabilitimin post-konfliktual.

Parimet kryesore të kësaj ambicieje janë: përfshirja, pjesëmarrja e të gjithëve, dhe barazia midis shteteve anëtare. Kushdo ka të drejtë të barabartë të fjalës dhe për të ndaluar një proces – në bazë konsensusi dhe bashkëpunimi.

Ky ishte një prezantim i OSBE-së. Dua t’ju inkurajoj të mësoni më shumë duke lexuar faqen tonë në internet, ku mund të gjeni informacion mbi aktivitetet aktuale dhe të mëparshme si dhe dokumentet bazë. Jemi gjithashtu në Twitter, Facebook dhe YouTube, ku pasqyrohen deklaratat dhe shkëmbimet më të rëndësishme në të kaluarën dhe aktuale.

Kur i bëjmë thirrje të gjithë shteteve anëtare të zbatojnë parimet e OSBE-së, nuk po kërkojmë diçka më tepër sesa zbatimin e parimeve demokratike të pranuara gjerësisht – këtu bashkohen edhe rrugët e BE-së dhe OSBE-së; dhe mund të themi me siguri që kemi të njëjtin qëllim – të shohim themelimin e një demokracie të plotë në vend, që do të thotë një vend ku palët e ndryshme të komunikojnë në mënyrë të qytetëruar në të gjitha nivelet, dhe të kërkojnë pika të përbashkëta dhe jo pika ku ato ndryshojnë. Vetëm duke punuar ngushtë së bashku, shqiptarët do të arrijnë qëllimet e tyre për t’u integruar plotësisht dhe për të hyrë në strukturat Euro-Atlantike.

Tani mund të them që jam i hapur për diskutim dhe për t’u përgjigjur pyetjeve që mund të keni.

Faleminderit për vëmendjen!

FUND

KONTROLLO PËRKUNDREJT FJALIMIT TË MBAJTUR